



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2.3.2022, ora 11:45

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit 7 – 25 mars 2022 dhe programit 7 mars – 15 prill 2022.
2. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore".
3. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit".
4. Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Europa krijuese” (2021- 2027)”.

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Besion Ajazi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Vangjel Dule, Tritan Shehu, Ilirjan Pendavinji, Bardhyl Kollçaku, Blendi Klosi dhe Kreshnik Çollaku.

Mungojnë:

Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Lavdrim Krrashi, Klodiana Spahiu, Grida Duma, Alqi Bllako, Belind Këllici, Greta Bardeli, Shpëtim Idrizi dhe Benet Beci.

Të ftuar:

Olta Manjani - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Albin Gega - Drejtor i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Astrit Hado - Drejtor i Përgjithshëm i ISSH-së

Andi Mahila – Zëvendësministër i Brendshëm

Eduart Merkaj – Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Ministrinë e Brendshme

Idriz Haxhiaj – Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike në Ministrinë e Brendshme

Suela Jahaj – Drejtor në Drejtorinë e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës

Entela Çipa - Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës

Anila Muka - Drejtore e Drejtorisë së Integritit

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Mirëdita, të gjithëve!

Kërkoj ndjesë për vonesën!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 2 mars 2022.

Në rendin e ditës kemi: miratimin e kalendarit të punës së komisionit për datat 7 – 25 shkurt 2022 dhe programin për datat 7 shkurt – 15 prill 2022.

Për projektligjin e parë "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore", ne jemi komision për dhënie mendimi dhe relatore është zonja Konomi.

Të ftuar kemi zonjën Manjani, zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë.

Mirë se vjen!

Zotin Gega, drejtor i Drejtorisë së Politikave të Punësimit dhe Aftësimit Profesional, dhe zotin Hado, drejtor i Përgjithshëm i ISSH-së.

Mirë se vini!

Më pas kemi projektligjin "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit", për të cilin jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Klosi.

projektligji i fundit në rendin e ditës është "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Europa krijuese (2021- 2027)". Jemi komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Ajazi.

Para se të miratojmë kalendarin e punës së komisionit për datat 7 dhe 25 shkurt, besoj se do të kemi një mbledhje të komisionit të hënën, pasi presim edhe komentet e një projektrezolute që kanë propozuar Komisioni i Jashtëm bashkë me Grupin Parlamentar të Partisë Socialiste dhe presim edhe vëzhgesat e kolegëve të opozitës. Kështu që, më lejoni të marr të drejtën që të mund të kemi jo vetëm për miratimin e kalendarit të punës, por edhe për një mbledhje të komisionit për ditën e hënë, nëse biem dakord, në mënyrë që të mund të kalojmë rezolutën që lidhet me situatën në Ukrainë dhe agresionin rus ndaj një vendi të pavarur, siç është Ukraina, të enjten në seancë plenare.

Nëse jeni dakord në parim me këtë gjë, atëherë e konsideroj programin e punës dhe kalendarin të miratuar.

Ju falënderoj!

Pa humbur kohë, fillojmë me diskutimin e projektligjit të parë "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore".

Fjala për ju, Zëvendësministre.

Olta Manjani – Faleminderit!

E nderuar kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë,

Propozimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës për sigurimet shoqërore" është në respektim dhe në përmbushje të procedurave ligjore të hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje kuadër, të nënshkruar midis dy vendeve tona në datën 26 nëntor 2021, si dhe një pjesë e procesit të koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera.

Marrëveshja e iniciuar është në përputhje me eksperiencën më të mirë ndërkombëtare në fushën e sigurimeve shoqërore, në konfirmim të vullnetit dhe angazhimit për thellimin e bashkëpunimit dhe çuarjen para të marrëdhënieve të shkëlqyera midis dy vendeve tona.

Në këtë frymë është finalizuar edhe procesi i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje kuadër, e cila ka nisur që në vitin 2020 me dy raunde dhe për hyrjen në fuqi dhe zbatimin efektiv të saj kërkon ratifikim respektiv nga dy kuvendet e vendeve tona.

Marrëveshja konsiston në ofrimin e përfitimeve të sigurimeve shoqërore dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të punëtorëve përmes punësimit për shtetasit të të njëjtave të drejtave dhe detyrimeve për mbrojtjen shoqërore me ato të shtetasve vendas.

Pjesë e parimeve kryesore të kësaj marrëveshjeje është parimi i ruajtjes së të drejtave të arritura, ku parashikohet që periudhat e sigurimit të realizuara në një shtet të njihen edhe nga shteti tjetër, me kushtin e vetëm që ato të mos mbivendosen dhe njëkohësisht edhe parimi i eksportimit të përfitimeve, i cili nënkupton të drejtën e çdo personi për të tërhequr përfitimin e siguruar, pavarësisht vendndodhjes së tij.

Gjithashtu, marrëveshja garanton që personat që lëvizin nga një vend në tjetrin dhe personat në varësi të tyre të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar dhe njëkohësisht

asnjë qytetar nuk do të humbasë asnjë kontribut, pavarësisht se në cilin prej dy vendeve ka punuar, për faktin e vetëm se bashkimi i periudhave bën të mundur plotësimin e kushteve ligjore për përfitimin e pensionit në të dyja vendet tona.

Objekt i kësaj marrëveshjeje janë përfitimet respektive nga skemat e sigurimeve shoqërore të të dyja vendeve. Përkatësisht nga skema shqiptare e detyrueshme e sigurimeve shoqërore, përfshihen elementet si më poshtë:

- Përfitimet në para të barrë lindjeve për personat e punësuar dhe personat e vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit.
- Përfitimet në para të aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale për personat e punësuar.
- Pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit.

Ndërkohë nga skema kosovare e sigurimeve shoqërore, përfshihen elementet si më poshtë:

E drejta në pension kontributpagues të moshës.

E drejta në pension të invaliditetit të punës.

E drejta në pension familjar.

E drejta në pension nga fondi i kursimeve të pensioneve individuale.

Referuar të dhënave zyrtare të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësisimit shtetas që janë aktualisht të pajisur me vërtetim deklarimi për punësim për periudhën janar-dhjetor të vitit 2020, janë 116 shtetas kosovarë dhe për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021, janë 161 shtetas kosovarë. Kryesisht ata janë të punësuar në fushën e industrisë përpunuese, prodhim brumërash dhe në sektorin bankar.

Ndërkohë, referuar të dhënave zyrtare nga Instituti i Statistikave, në vitin 2020 kanë aplikuar për leje qëndrimi 916 shtetas kosovarë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, referuar të dhënave zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, leje qëndrimi të përkohshme për arsye pune, me të cilën janë pajisur shtetas shqiptarë në Kosovë për periudhën janar-dhjetor të vitit 2020 janë 454 shtetas shqiptarë dhe për periudhën janar-dhjetor të vitit 2021 janë 543 shtetas shqiptarë.

Zbatimi i kësaj marrëveshjeje nuk do të ketë efekte financiare të menjëhershme, pasi e drejta për përfitime nga këto skema të sigurimeve shoqërore shtetasve shqiptarë u lindi në momentin e një periudhe të dytë, pra kur kanë mbushur moshën e pensionit.

Këto efekte financiare janë në kërkim të fondit buxhetor të ISSH-së dhe financohen nga kontributet përkatëse.

Marrëveshja parashikon gjithashtu edhe dhënie përfitimi vetëm për kontributet e paguara për periudhat në fjalë.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zëvendësministre!

Fjala për relatoren.

Hatixhe Konomi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit edhe përfaqësuesve të Ministrisë së Financave për prezantimin e projektligjit!

Të gjithë e dini që sigurimet shoqërore janë një pjesë shumë e rëndësishme e sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri, kështu që, pa dyshim, janë shumë të rëndësishme për qytetarët, ndaj gjykoj që edhe mbështetja e projektligjit të sotëm është me interes për qytetarët që na dëgjojnë.

Pavarësisht se kjo është një marrëveshje kuadër, ky projektligj ka për qëllim t'u krijojë mundësinë e përfitimit të pensioneve shqiptarëve që jetojnë dhe punojnë në Kosovë si për shtetasit kosovarë, të cilët vijjnë për të punuar në Shqipëri.

Është një marrëveshje e miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave më 24.11.2021 dhe bazohet në parimin e trajtimit të barabartë të personave të punësuar, të të vetëpunësuarve dhe punëdhënësve, duke harmonizuar legjislacionet kombëtare të të dyja vendeve për përfitimet që kanë të bëjnë me sëmundjet, barrëlindjet, aksidentet në punë, sëmundjet profesionale për personat e punësuar për pensionin e pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare nga skema e detyrueshme shoqërore.

Gjithashtu, në dispozitat e kësaj marrëveshjeje dypalëshe reflektohen të gjitha rregullat për koordinimin e skemave shoqërore për personat e punësuar, të vetëpunësuar dhe punëdhënësit, të cilat janë të përcaktuara në Rregulloren e Këshillit nr. 1408/71 dhe Rregulloren nr. 883/2004 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të Europës.

Objekti i kësaj marrëveshje (pa dashur të përsëris ato që tha ministrja) përfshin kategorinë siç janë: përfitimet në para për barrëindje për personat e punësuar dhe ata të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit; përfitimet në para të aksidenteteve në punë dhe sëmundjeve profesionale për personat e punësuar; pensionet e pleqërisë, të invaliditetit dhe familjare për personat e punësuar dhe të vetëpunësuar, si dhe për punëdhënësit.

Ndër të tjera, rregullat koordinuese të kësaj marrëveshjeje garantojnë që personat që lëvizin nga një vend në tjetrin dhe personat në varësi të tyre të ruajnë të drejtat e fituara apo që janë duke i fituar.

Bashkimi i periudhave të siguruara, sipas legjislacionit kombëtar të ndryshëm, merret në konsideratë për të siguruar të drejtat e përfitimeve dhe llogaritjen e tyre. Në fakt, te bashkimi i periudhave të siguruara do të doja të ndalesha në pjesën e tretë të kapitullit II të kësaj marrëveshjeje, ku përcaktohet bashkimi i periudhave të sigurimit për përfitimin e pensionit të pleqërisë, pensionin familjar dhe pensionin e invaliditetit me kusht që ato të mos mbivendosen. Në rast se do të kemi mbivendosje në të dyja shtetet, Shqipëria do të marrë parasysht vetëm periudhat e sigurimit të realizuara në territorin e saj.

Sa u takon efekteve financiare, edhe ato u sqaruan që nuk janë të menjëhershme, por maturimi i kësaj marrëveshjeje është afatgjatë.

Po ashtu, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, të gjithë këta persona do të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore dhe kontributeve shqiptare nëse do të kenë të paktën 15 e më shumë vite në punë si të siguruar.

Pa dashur të zgjatem, ju bëj thirrje të gjithëve ta votojmë këtë ligj.

Ju falënderoj!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zonja Konomi!

Para sa t’ua jap fjalën për pyetje dhe diskutime, kolegë, po ia lejoj vetes ta marr fjalën e para, pasi doja t’ju komplimentoja për këtë marrëveshje që sillni sot dhe do të kisha dashur t’ju ftoja që të punonit më intensivisht, që këtë marrëveshje të mund ta realizonit edhe me vende të tjera, ku qytetarët shqiptarë punojnë dhe paguajnë sigurime shoqërore. Di që është bërë një përpjekje e jashtëzakonshme edhe në finalizimin me qeverinë italiane, por doja t’ju ftoja që kjo gjë të mund të intensifikohej qoftë me qeverinë greke apo me qeveritë e të gjitha vendeve, ku punojnë dhe jetojnë shqiptarët.

Në dijeninë time Italia, për shembull, ka të njëjtën marrëveshje me një vend si Franca dhe ne shumë mirë mund të kishim marrë eksperiencën e tyre për mënyrën se si ata kanë mbërritur ta ngrenë këtë marrëveshje në nivelin e ratifikimit të një ligji me një vend të BE-së, siç është Franca.

Kush e do fjalën? Ministri Shehu, pastaj kolegu Çollaku, pastaj kolegu Kollçaku.

Tritan Shehu – Zonja kryetare, realisht jam njohur me këtë marrëveshje edhe në Komisionin e Çështjeve Sociale dhe jemi dakord të gjithë, madje i shtymë dhe i sugjeruam që të vazhdojnë me marrëveshje të tjera të këtij lloji. Personalisht jam dakord dhe nuk kam asgjë kundër kësaj marrëveshjeje, pasi është e dobishme dhe duhet implementuar.

Gjithashtu, meqë më duhet ta lë mbledhjen, pasi kam një angazhim tjetër, do të doja të thosha se jam dakord edhe me dy marrëveshjet e tjera dhe nuk kam asgjë kundër.

Ju falënderoj!

Mimi Kodheli – Të falënderoj për bashkëpunimin, koleg! Realisht e vlerësoj!

Fjala për kolegun Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zonja kryetare!

Edhe unë u bashkohem komplimenteve që iu bë draftimit të kësaj marrëveshjeje dhe patjetër që e mbështesim, madje e nxisim në të tjera të ngjashme të kësaj natyre.

Vlerësoj referimin që ju bëtë, që e njëjta marrëdhënie duhet parë edhe në vende të tjera, ku ne kemi interes dhe ku banojnë dhe punojnë shqiptarët, kështu që në parim nxisim që të zhvillohet edhe me vendet e tjera.

Do të doja të ndalesha në mënyrë më specifike lidhur me marrëdhëniet tona në raport me Kosovën. Fakti që ne e trajtojmë Kosovën ndonjëherë si të barabartë me vende të tjera, mendoj se është një lloj pengese psikologjike që ne ia krijojmë vetes. Shqipëria ka respektuar sovranitetin e Kosovës, kufijtë shtetëror të saj, dy shtete të ndryshme të pavarura, dhe ky është detyrimi ynë ndërkombëtar dhe i ndershëm në raport me Kosovën. Por unë nuk e kuptoj se përse duhet të krijojmë vetëpengesa psikologjike që marrëveshje të kësaj natyre apo shumë të tjera... Po ju them një rast konkret, bisedova me disa deputetë të Kuvendit të Kosovës, të Komisionit të Ekonomisë, të cilët kishin një pretendim “Pse duhet të vazhdojë ende pengesa për regjistrime të bizneseve të ndryshme apo entiteteve që duan të zhvillojnë aktivitete tregtare të Kosovës në Shqipëri dhe pse duhet të mos përfitojnë disa lehtësira të natyrës stimuluese apo individëve?”.

Unë mendoj se askush nuk na ndalon përveçse vetëfrenimit tonë psikologjik dhe nxitjes, përshpejtimit dhe fokusimit të energjive tona në unifikimin sa më parë të një hapësire ekonomike legislative të përafrimit me Kosovën.

Predispozita është e natyrshme, sepse bëhet fjalë për një komb të ndarë në gjysmë në respekt të dyshtetësive, për potencialet e bashkëpunimeve ekonomike, pse jo edhe të hartimit të politikave ekonomike të unifikuara të përbashkëta dhe nuk ka pse të na pengojë asgjë përveçse komplekseve tona. Kështu që, mendoj t'i qasemi sa më parë pa rezerva kësaj historie (nuk e kam për sigurimet, por për politikat arsimore të përbashkëta, në politika zhvillimore turizmi të përbashkëta, në ekonomi të përbashkët, në lehtësim të mundësive të operatorëve të biznesit për të vepruar këtu apo anasjelltas), pra askush nuk na pengon të krijojmë këtë lloj hapësire bashkërenduese. E bëjmë këtë gjë me të gjitha vendet drejt BE-së, të paktën niveli që punojmë me unifikimin e legjislacioneve dhe marrëdhënieve me BE-në, nuk mundet të bien poshtë atij niveli me Kosovën ku predispozita natyrore është edhe shumë më e madhe, afria, kultura, njëkombësia e të tjera me radhë.

Kështu që, do të doja të nxisja një reflektim më të gjerë në raport të marrëdhënieve të Republikës së Shqipërisë me Republikën e Kosovës, pa kompleksin se çfarë do të thonë të tjerët. Ne respektojmë kufijtë, respektojmë stabilitetin, respektojmë të gjithë kuadrin ndërkombëtar, por askush nuk na pengon që të hartojmë politika të përbashkëta turizmi, t'i unifikojmë këto politika siç e bëjmë edhe me Maqedoninë e Veriut, sepse mund të kompleksohemi në raport me Kosovën.

Për licencimin e bizneseve duhet të ketë stimuj për aktivitete të tilla financiare (nuk dua të bëj ekspertin e një fushe ku nuk jam, si ekonomia), por ndiej nevojën edhe nga pala andej që ka nevojë që të krijojmë këtë hapësirë të lehtësuar komunikimi qoftë për qytetarët, bizneset apo për raportet tona ndërshtetërore dhe një vatre të përbashkët ekonomike të zhvillimit të vendeve tona.

Këto kisha në parim.

Patjetër që e përshëndes marrëveshjen dhe e nxis madje, që të ketë sa më shumë të tjera, sidomos me Kosovën.

Mimi Kodheli – Faleminderit, kolegu Çollaku!

E vlerësoj angazhimin tuaj!

Para se t'ia jap fjalën deputetet Kollçaku, shpresoj të jetë shterues në diskutimin e tij.

Do të doja vetëm të ktheja në vëmendje se qysh prej vitit 2013 qeveria shqiptare në vazhdim ka bërë mbledhje të përbashkëta me qeverinë e Kosovës. Kjo ka qenë një risi dhe sigurisht që përafron dhe ndihmon në lehtësimin e procedurave në realizimin apo miratimin e ligjeve të përbashkëta, të cilët thjeshtojnë dhe ndihmojnë jo vetëm këtë procedurë për të cilën po flasim, por atë që ju me të drejtë thatë, shtimin e aktivitetit ekonomik dhe financiar nga të dyja krahët, punësimin e kështu me radhë. Kështu që e vlerësoj atë që thoni.

Kreshnik Çollaku – Gjatë periudhës që ju iu referuat kemi bërë një opozitë shumë të fortë kritike me njëri-tjetrin dhe vazhdojmë të mbetemi kritikë në shumë gjëra, por personalisht, nëse ka pasur një akt përmes gjithë opozitarisë dhe kundërshtimit që kemi pasur, që unë e kam përshëndetur dhe s’kam asnjë kompleks ta përshëndes, kanë qenë mbledhjet e përbashkëta të dy qeverive. Kritika që kam për atë sektor janë rezultatet e prodhuara nga këto mbledhje, sepse është mirë si precedent që takohen por duhet nxitur edhe rezultati, sepse mbledhjet pa rezultat përfundojnë në diçka që bëhet krejt formale.

Mimi Kodheli – Kjo është një arsye më shumë për ta ftuar qeverinë që të nxjerrë sa më shpejt aktet nënligjore, në mënyrë që marrëveshja të bëhet funksionale.

Zoti Kollçaku, fjala për ju.

Bardhyl Kollçaku – Faleminderit, zonja kryetare!

E dëgjuam me vëmendje prezantimin nga Ministria e Financave. Në vijim të asaj që ju thatë për të pasur edhe në vazhdim marrëveshje të tilla, jo vetëm ky komision, por edhe parlamenti i mbështet.

Unë kam një pyetje për zëvendësministren: a keni një informacion për statusin dhe ecurinë e marrëveshjeve të tilla me vende të ndryshme ku jetojnë shqiptarët, atë që sapo thatë edhe ju, dhe pastaj çfarë mund të bëjë ky komision apo komisionet e tjera për t’i avancuar këto marrëveshje shumë të rëndësishme, pasi bëhet fjalë për prekjen direkt të mirëqenies dhe të ardhurave të shqiptarëve që jetojnë në çdo cep të globit?

Duke përfituar nga rasti, dua të komplimentoj drejtuesit e ISSH-së për bashkëpunimin që kanë pasur në detyrat e mëparshme për profesionalizmin, por edhe gatishmërinë për të mbështetur ushtarakët në rezervë, në pension apo lirim apo ata kalimtarë!

Pyetja që lidhjet me draftmarrëveshjen aktuale është teknike, sepse është në detaje. Diku thoni që u lind e drejta, pasi të kenë punuar 15 vjet, sipas ligjit që kemi edhe ne. Pyetja që unë kam është: a kemi një mbledhje akumulative? Pra, në qoftë se ka punuar 3 vjet në Kosovë, e

merr vërtetimin që ka punuar, këto i shtohen kontributit që ka pasur në Republikën e Shqipërisë ose anasjelltas dhe çfarë ndodh? Në disa vende është që nuk mund të marrë dy pensione, pra dorëzon pensionin këtu, nëse është në Greqi, është një rast i tillë dhe nuk mund t'i marrë të dyja. Po nëse punon 15 vjet në Kosovë dhe 15 vjet në Shqipëri, a mund të përfitojë një shtetas dy pensione qoftë ai shqiptar, qoftë kosovar?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Kollçaku!

Fjalën e ka zoti Alizoti.

Më pas fjalën e kanë të ftuarit.

Tomor Alizoti – Pyetja më erdhi, pasi dëgjova zotërinë që foli për pensionin e ushtarakëve. Ndoshta kjo mund të mos jetë pjesë e diskutimit të sotëm, por dua të di, çfarë është bërë me të burgosurit politikë, të cilët kanë punuar të detyruar nëpër miniera? Këtë duhet të ma sqaroni ju. Kanë bërë punë të tmerrshme skllavëruese të marrë peng nga shteti i asaj kohe, jo vetëm në miniera, por kudo që ata kanë punuar. A marrin ata një pension dhe në çfarë vlere?

Kjo është pyetje morale, sepse kam dëgjuar, por nuk e di të saktë, që xhelatët e tyre kanë pension më të lartë se ata që kanë torturuar. A është e vërtetë kjo? A mund të më informoni pak në lidhje me këtë?

Mimi Kodheli – Fjalën e ka zëvendësministrja Manjani.

Më pas fjalën e ka zoti Hado.

Olta Manjani – Faleminderit për pyetjet!

Fillimisht do t'i adresohem pyetjes së zotit Kollçaku dhe të zonjës kryetare. Aktualisht marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara në fushën e sigurimeve shoqërore, të cilat janë fuqi dhe janë të zbatueshme, kemi me Hungarinë, Çekinë, Gjermaninë, Luksemburgun, Austrinë, Turqinë, Belgjikën dhe me Bullgarinë, ndërsa marrëveshje të nënshkruara dhe në proces miratimi aktualisht Shqipëria ka me Konfederatën Zvicerane. Ndërkohë, shumë shpejt do të fillojmë negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes me Italinë, e cila është një marrëveshje e një rëndësie së veçantë për shkak edhe të numrit shumë të lartë të shqiptarëve që punojnë në Itali, por edhe të numrit gjithnjë e në rritje të shtetasve italianë, të cilët aktualisht punojnë dhe jetojnë në territorin shqiptar.

Sa i takon pyetjes për teknikalitetet e marrëveshjes do t'ia kaloj fjalën drejtorit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i cili mund t'ju japë një përgjigje më gjithëpërfshirëse sa i takon pyetjes së ngritur nga ju.

Astrit Hado – Faleminderit, zonja zëvendësministre!

Në lidhje me pyetjen që bëri zoti Kollçaku, në marrëveshje është parashikuar totalizimi i periudhave kontributive me qëllimin kryesor plotësimin e kriterëve ligjore për të përfituar një pension. Ne në ligjin shqiptar e kemi që duhet të kesh minimalisht 15 vjet sigurim dhe kjo marrëveshje është pikërisht për këtë gjë. Periudhat e sigurimit të realizuara në territorin e Kosovës nga një qytetar shqiptar do të konsiderohen sikur janë periudha sigurimi të realizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë me qëllim plotësimin e kushtit ligjor 15 vjet.

Pra, nëse është një qytetar shqiptar që ka vetëm 10 vjet punë në Shqipëri dhe me 10 vjet punë ai nuk ka të drejtë të marrë një pension në Shqipëri, në qoftë se ka një periudhë pune 5 vjet ose më shumë në Kosovë, bëhet totalizim, bashkimi i periudhave kontributive me qëllim që të realizohet plotësimi i kushtit ligjor dhe më pas pensioni do të llogaritet sipas ligjeve të vendeve respektive dhe do të paguhet në atë masë sa kanë kontribuar vendet. Edhe nëse ka raste kur një person ka punuar në 3 apo 4 shtete me të cilat Shqipëria ka marrëveshje, të gjitha këto periudha kontributive totalizohen për të plotësuar kriterin ligjor dhe më pas secili shtet llogarit pensionin, sipas kontributit të paguar.

Në lidhje me pyetjen që bëri zoti Tomor Alizoti, për ish-të përndjekurit politikë, të cilët që e kanë vuajtur periudhën e dënimit nëpër burgje, periudha, përveç dëmshpërblimeve të tjera që u janë dhënë jashtë strukturës ose jashtë sistemit të sigurimeve shoqërore sa i përket sistemit të pensioneve, çdo vit burg politik konsiderohet si vjetërsi pune dyfish, pra 1 vit burg është i barabartë me 2 vjet periudhë sigurimi të një pune të kategorisë së parë, puna që ka shkallën më të lartë të vështirësisë. Në rastet kur është i internuar, edhe periudha e internimit, kur është në moshën normale për punë, 14 vjeç, siç ka qenë në atë kohë, automatikisht konsiderohet si periudhë pune në zonë urbane, pra mund të ketë punuar në kooperativë, por kjo periudhë konsiderohet sikur ka punuar në një ndërmarrje shtetërore.

Një veçori tjetër sa u takon ish-të përndjekurve politikë është që në rastet kur pensioni i llogaritur, sipas formulës së përcaktuar është më i ulët se pensioni mesatar, automatikisht masa e pensionit kalon në pension mesatar në shkallë vendi, që është mesatarja e pensionit minimal me pensionin maksimal.

Për ish-të përndjekurit politikë që kanë vuajtur dënimin në burgjet me minierë, kanë qenë dy burgje të tilla e Qafës së Barit dhe Spaçi, jo Burreli se nuk ka pasur minierë, kanë qenë kampe të vuajtjes së dënimit me punë në minierë, pra nën tokë, kjo periudhë e vuajtjes së dënimit konsiderohet 2 vjet punë në minierë, në nëntokë. Për shkak të këtij përkufizimi vetëm për atë periudhë që kanë bërë burg në këto dy institucione përfitojnë shtesën e pensionit që është në masën 1% për çdo vit të pensionit.

(Diskutime pa mikrofon)

Tomor Alizoti – Ka pasur shumë pak që i kanë rezistuar dhunës për të mos punuar. Edhe këtyre personave u quhet sikur kanë punuar në minierë apo kjo është pak specifike?

Astrit Hado - Për dy burgjet që ju përmenda, Qafën e Barit dhe Spaçin, pavarësisht nëse kanë punuar ose jo, automatikisht është periudhë e vuajtjes së dënimit. Në fakt, ne kemi edhe një problematikë për këtë pikë, pasi Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Burgjeve shpeshherë nuk kanë pasur dokumentacion të saktë për të vërtetuar nëse këta persona e kanë kryer apo jo dënimin në këto burgje, kjo për shkak të lëvizjeve nga njëri burg tjetrin. Ne kemi një bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Drejtësisë, Drejtorinë e Burgjeve dhe Autoritetin e Dosjeve me qëllimin që çdo lloj dokumenti i mundshëm që provon faktin e të qenit në këto burgje, të konsiderohet. Ligjvënësi e ka marrë parasysh të gjithë periudhën, pavarësisht nëse ka punuar në minierë, në kuzhinë apo ka bërë ndonjë punë tjetër në sipërfaqe, automatikisht e gjitha është konsideruar si punë në nëntokë.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti Hado!

A ka ndonjë koment tjetër? Nuk ka.

Po e hedh projektligjin në parim në votim.

Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Fillojmë me nenet.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Hedhim projektligjin në votim në tërësi.

Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet projektligji.

Ju falënderoj për prezencën dhe punë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 2.3.2022, ora 11:45

Drejtton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit”.*(Komision për dhënie mendimi)*

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Besion Ajazi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Vangjel Dule, Tritan Shehu, Ilirjan Pendavinji, Bardhyl Kollçaku, Blendi Klosi dhe Kreshnik Çollaku

Mungojnë:

Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Lavdrim Krashi, Klodiana Spahiu, Grida Duma, Alqi Bllako, Belind Këllici, Greta Bardeli, Shpëtim Idrizi dhe Benet Beci.

Të ftuar:

Andi Mahila – Zëvendësministër i Brendshëm

Eduart Merkaj – Drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin në Ministrinë e Brendshme

Idriz Haxhiaj – Drejtor, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike në Ministrinë e Brendshme

Suela Jahaj – Drejtore, Drejtoria e Integritit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Brendshme

Mimi Kodheli – Vazhdojmë me projektligjin e dytë “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit”. Për këtë projektligj komisioni ynë është komision për dhënie mendimi. Relator është zoti Klosi.

Të ftuar nga Ministria e Brendshme janë zoti Mahila, zëvendësministër, Eduart Merkaj, drejtor i Departamentit për Kufirin dhe Migracionin, zoti Idriz Haxhiaj, drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme e Politikave për Rendin dhe Sigurinë Publike dhe zonja Suela Jahaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Integritetit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës.

Zoti zëvendësministër, dy fjalë për projektligjin.

Andi Mahila – E nderuar kryetare e komisionit,

Të nderuar deputetë, anëtarë të komisionit,

Do të doja të theksoja në fillim të prezantimit qëllimin e projektaktit që qeveria shqiptare ka sjellë për ratifikim në parlamentin e Shqipërisë, marrëveshjen ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për rregullat e regjimit të trafikut lokal të kufirit sjelljen e bashkëpunimit të dy shteteve më pranë njerëzve, duke e dërguar në një fazë tjetër më të lartë të lehtësimin e lëvizjes së lirë, lehtësimin e punësimit dhe ndërveprimi më i madh mes dy bashkësive në të dyja anët e kufirit.

Paraqitja për miratim e këtij projektakti bazohet në nenin 100 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare me Republikën e Shqipërisë”. Marrëveshja është iniciuar në kuadër të angazhimeve të përbashkëta të dy qeverive me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave dhe të masave të lidhura me regjimin e trafikut kufitar lokal dhe të lejeve për këtë qëllim përgjatë kufirit. Kjo marrëveshje është një ndër 3 aktet nënshkruara gjatë vitit të kaluar ndërmjet qeverive të dy vendeve, të iniciuara nga Ministria e Brendshme, të cilat krijojnë kushte shumë më të favorshme për të dyja anët e kufirit për akses në tregun e punës dhe për një tjetër hap për bashkimin gradual të dy tregjeve në një hapësirë të vetme ku shqiptarët mund të punojnë, të studiojnë, të krijojnë familje, të aksesojnë çdo shërbim dhe të dalin në pension, duke përfituar çdo kontribut dhe të drejtë sociale, pavarësisht vendndodhjes gjeografike në Shqipëri apo në Kosovë. Në veçanti marrëveshja në fjalë krijon lehtësi për banorët e Republikës së Shqipërisë në zonat kufitare me Kosovën.

Është e rëndësishme të ritheksohet fakti, ashtu siç është bërë edhe më parë, që këto marrëveshje në mënyrë të veçantë u shërbejnë shtetasve shqiptarë, përfshirë këtu, përveç kësaj

marrëveshjeje që jemi duke diskutuar, miratimin e lejeve të punës dhe të qëndrimit 5-vjeçar si një dokument i vetëm, i cili jepet në mënyrë të përsheptuar, përmirësimin e statusit dhe zgjerimin e shërbimeve të pikës së përbashkët të kalimit kufitar të Shishtavecit, shfrytëzimi i së cilës do të bëhet në mënyrë të plotë nga banorët e zonës, përfshi shërbimet doganore, por edhe e hapur për kalim të çdo shtetasi pa kufizim banimi.

Sipas kësaj marrëveshjeje zona kufitare e lëvizjes së lirë të banorëve me leje të trafikut kufitar lokal është deri në thellësinë 30 kilometra brenda territorit të palëve nënshkruese. Marrëveshja synon të lehtësojë një qarkullim të lirë të banorëve për të dy anët e kufirit, të pakufizuar nga vendkalimet aktuale, siç i quajmë pikat e kalimit kufitar, por në segmente më të gjera përgjatë vijës së kufirit shtetëror pa nevojën e vulosjes apo të regjistrimit të dokumenteve të identifikimit dhe të mbikëqyrjes momentale fizike të autoriteteve për ruajtjen dhe kontrollin e kufirit.

Zonat e kalimit kufitar, të cilat janë pjesë e kësaj marrëveshjeje përfaqësojnë lidhjen natyrore, gjeografike, por edhe demografike midis dy anëve të kufirit dhe të popullsisë që i popullojnë këto zona, të cilat kanë bashkëjetuar dhe ndërvepruar midis tyre historikisht. Ky ndërveprim u ka siguruar jetesën dhe mirëqenien familjare dhe individuale deri më sot.

Të nderuar deputetë,

Më lejoni të ndaj me ju disa shifra në mënyrë që të jetë më e qartë për ju dhe për të gjithë ata që do të përfitojnë nga ratifikimi i kësaj marrëveshjeje.

Nga kjo marrëveshje përfiton një popullsi prej më shumë se 98 mijë banorë, e shtrirë në 3 qytete dhe në 19 njësi administrative. Vetëm gjatë periudhës së pandemisë nga këto zona janë mjekuar dhe trajnuar, në kuadër të pandemisë apo edhe për nevoja të tjetra shëndetësore, një numër i madh banorësh të këtyre zonave. Banorët do të kursejnë kohën dhe shpenzime të tjera për t'i përmbushur nevojat e tyre në anën tjetër të kufirit.

Më konkretisht, nëse një banori të Krumës i duhet të udhëtojë rreth 50 kilometra për të kaluar kufirin në grykën e Morinës apo 20 kilometra në pikën tjetër kufitare më të afërt në Qafë Prush, me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje çdo banor i Krumës do të kalojë në Dobrun ose në Llahem...

Mimi Kodheli – Zoti zëvendësministër, e kuptoj që doni të jeni sa më sqarues për komisionin, por nuk besoj se specifikimet teknike të kësaj natyre i interesojnë Komisionit për Politikën e Jashtme, i cili është këtu për të vlerësuar nëse projektligji që ju keni paraqitur për

ratifikimin e kësaj marrëveshjeje konvenon dhe është në respekt të të gjithë kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe në përputhje edhe me kuadrin ligjor të të gjitha marrëveshjeve ku Shqipëria aderon. Nëse ju do të jeni më shterues, do ta vlerësoja shumë këtë gjë.

Andi Mahila – Faleminderit!

Po i heq sqarimet.

Ky projektakt është në koherencë të plotë me përmbushjen e prioriteteve të qeverisë shqiptare për lehtësimin e kalimit kufitar me vendet fqinj. Marrëveshja vjen në përputhje me strategjinë kombëtare për menaxhimin e integruar të kufirit dhe planin e veprimit të saj 2021-2027.

Të gjitha gjërat e tjera të nevojshme janë të pasqyruara në relacionin që Ministria e Brendshme ka paraqitur pranë komisionit.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Ju falënderoj për mirëkuptimin!

Zoti Klosi, fjala për ju.

Blendi Klosi – Faleminderit, kryetare!

Në fakt, ky është një ndër projektligjet, i cili do të ketë konsensus të plotë në komision dhe në këtë mënyrë lehtëson edhe detyrën e relatorit. Në vazhdim të diskutimit që u bë më parë, por edhe të atyre që tha zëvendësministri, pa dyshim ky është një produkt i tryezave të përbashkëta ndërmjet dy qeverive tona, të cilat tashmë janë 100% në mbështetje, duke pasur parasysh edhe atë që tha kolegu Çollaku, të politikave të përbashkëta, të mirëkoordinuara dhe të dakordësuara me qeverinë e Kosovës.

Kur isha ministër i Turizmit, në detyrat që unë kam pasur kemi pasur shumë bashkëpunim dhe turizmi, siç e përmendi edhe kolegu, është një ndër fushat ku kemi pasur çdo gjë të rakorduar me Kosovën, gjë që dëshmon atë që duhet të ndodhë më shumë sesa çfarë bëjnë qeveritë apo institucionet tona. Këtë gjë e ka bërë më së miri tregu dhe tashmë qytetarët e të dy anëve të bjeshkëve e jetojnë turizmin si një të tërë, ndërsa ne në fakt kemi bërë shumë më pak sesa ajo që ka bërë Komiteti i Biznesit dhe vetë qytetarët. Tashmë nuk ka më asnjë dyshim që turizmi është një, në Shqipëri deti shfrytëzohet nga të dyja anët e bjeshkëve si i përbashkët, pa diskutim ky është det që u takon të gjithëve, shqiptarëve të Shqipërisë apo të anës tjetër të kufirit, siç janë edhe bjeshkët dhe të gjitha bukuritë natyrore të Kosovës, të cilat gjithmonë e më shumë po shijohen nga të gjithë.

Unë kam nderin të jem relator i këtij projektligji, por mendoj se do të duhej të ishte pjesë e relacionit apo e diskutimit tonë parlamentar, por edhe ajo që ka thënë Kryeministri Rama, ka ardhur koha, zoti zëvendësministër, që ne t'i eliminojmë fare lejet e qëndrimit, të punës dhe praktika të tjera si këto, edhe pse ky projektligj i lehtëson mjaft këto praktika. Unë mendoj që për të gjithë shqiptarët e të dyja anëve të bjeshkëve këto leje nuk duhet të ekzistojnë fare, prandaj do të doja ta ritheksoja këtë moment, eliminimin e lejeve të qëndrimit, të lejeve të punës, si edhe të asaj që përpiqen qeveritë, eliminimin e pikave doganore dhe të regjistrimit në kufi të lëvizjes së qytetarëve.

Në këtë kuadër ky është një hap përpara, por përsëri është një hap në vrapin e madh që duhet të ndërmarrim të gjithë së bashku pa asnjë ndarje politike për ratifikimin dhe dakordësinë e të gjitha politikave që kemi me vëllezërit tanë përtej bjeshkëve. Kufiri është një koncept, i cili nuk duhet të jetë më në këtë tryezë.

Mimi Kodheli – E falënderoj kolegun Klosi jo vetëm për referimin, por edhe për çka tha më tej dhe e mbështes plotësisht.

Nëse nuk ka ndonjë koment, fjalën e ka zoti Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj edhe zëvendësministrin për të gjitha sqarimet!

Unë patjetër që e mbështes në mënyrë absolute këtë projekt. E vetmja çështje që doja t'ju pyesja, ndjesë në rast se ju duket shumë e thelluar, bëhet fjalë për një status të veçantë që përfitojnë banorët në lirshmërinë e lëvizjes të hapësirës prej 30 kilometrash nga të dyja anët e kufirit. A ka ndonjë pengesë që kjo hapësirë prej 30 kilometrash të mund të zgjerohet? A ka ndonjë pengesë në konventa dhe detyrime, pse jo 50 kilometra dhe jo i gjithë territori në mënyrë, që çdo banor ta gëzojë këtë status lëvizshmërie? Çfarë na pengon ta realizojmë si standard?

Mimi Kodheli – A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Fjalën e ka zëvendësministri për t'u përgjigjur.

Andi Mahila – Në vijim të fjalës së deputetit Klosi, dua të theksoj pjesën e heqjes fare të lejeve të qëndrimit apo të lejeve të punësimit, sepse ky është objektivi. Detyra e lënë për ne si ekzekutiv nga Kryeministri Rama në mbledhjen e përbashkët të të dy qeverive ishte që këto marrëveshje që janë firmosur të zbatohen, ky është vrap për zbatimin e këtyre marrëveshjeve.

Sa i takon pjesës së heqjes fare të lejeve të qëndrimit apo të lejeve të punësimit, të cilat në bazë të ligjit të ri të Shqipërisë për të huajt janë unifikuar në një, leja e qëndrimit dhe e

punësimi, për shtetasit e Kosovës në legjislacionin tonë është bërë përjashtimi për 5 vjet, pra e marrin lejen e qëndrimi dhe të punësimi për 5 vjet, ndërkohë që shtetasit e tjerë e kanë për 1 vit.

Po kaloj te pjesa e zonës 30 kilometra. Në fakt, parimi i hapjes ose i krijimit të fashave të zonave të lëvizjes së lirë prej 30 kilometrash është një nocion që nuk e kemi huazuar, por i jemi referuar legjislacionit dhe praktikave europiane. Në legjislacionin ndërkombëtar është e përcaktuar 25 deri 30 kilometra. Kjo marrëveshje, natyrisht nuk është pjesë e përafrimit të legjislacionit tonë me legjislacionin e BE-së në, se e kemi theksuar këtë në relacion, por që u referohet eksperiencave të vendeve europiane. Drejtori i politikave mund t'ju sqarojë më tepër.

Kreshnik Çollaku - A na pengon ose çfarë na pengon që këtë status që e përfitojnë 98 mijë qytetarë, siç thatë ju, ta përfitojnë 3 milionë qytetarë në të dy krahët e kufirit? Pra, a ka ndonjë pengesë?

Andi Mahila - Faleminderit!

Kontrolli i kufirit rregullohet me ligj të veçantë organik, i cili thekson se kalimi i kufirit bëhet në pika kalimi të miratuara. Dhe kjo është për të gjithë popullsinë. Marrëveshja për të cilën jemi mbledhur sot dhe po prezantojmë është përjashtim nga ligji dhe rregullohet me trafikun lokal, i cili është i kufizuar. Qëllimi i marrëveshjes është për t'iu ardhur në ndihmë banorëve të zonës kufitare në thellësinë 30 kilometër nga vija kufirit. Jemi mbështetur në rregulloren e BE-së 1931 e vitit 2006 dhe në shumë elemente të saj. Ashtu siç është rregulluar trafiku lokal midis vendeve të BE-së jashtë pikave të kalimit të miratuara ndërkombëtarisht është edhe kjo marrëveshje. Pra, për pjesën tjetër të popullsisë kalimi i kufirit bëhet në pikat e kalimit të miratuara ndërkombëtarisht. Për pjesën e popullsisë lokale pranë vijës së kufitarit është përcaktuar leja e posaçme që e gëzojnë vetëm këta përsëri bazuar në kriterin që ka direktiva. Ata që banojnë minimumi një vit në këto zona, e gëzojnë këtë status që të marrin lejen e kalimit kufitar lokal.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Në se nuk ka pyetje dhe komente e hedhim në votim.

Kush është dakord? Kundër? Abstenime. Jemi të gjitha dakord.

Miratohet.

Neni 1 Kush është dakord? Kundër? Abstenime. Jemi të gjitha dakord.

Miratohet.

Neni 2 Kush është dakord? Kundër? Abstenime. Jemi të gjitha dakord.

Miratohet.

Kush është dakord për marrëveshjen në tërësi? Kundër? Abstenime. Jemi të gjitha dakord.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.03.2022, ora 11.45

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin Europa krijuese (2021- 2027)".

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Besion Ajazi, Tomor Alizoti, Hatixhe Konomi, Vangjel Dule, Tritan Shehu, Ilirjan Pendavinji, Bardhyl Kollçaku, Blendi Klosi dhe Kreshnik Çollaku.

Mungojnë:

Etjen Xhafaj, Petro Koçi, Lavdrim Krashi, Klodiana Spahiu, Grida Duma, Alqi Bllako, Belind Këlliçi, Greta Bardeli, Shpëtim Idrizi dhe Benet Beci.

Të ftuar:

Entela Cipa - Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës

Anila Muka - Drejtore e Drejtorisë së Integritimit

Mimi Kodheli - Kalojmë në projektligjin e fundit për sot.

Të ftuar kemi zonjën Çipa, sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Kulturës dhe zonja Muka drejtore e Integritimit.

Zonja Çipa fjala për ju.

Entela Çipa – Faleminderit!

Po prezantojmë para jush projektligjin, i cili mbështet në nenet 78 dhe 83, pika 1 dhe 121 të Kushtetutës si edhe është në përputhje për ligjin me marrëveshjet ndërkombëtare i vitit 2016 dhe me marrëveshjen e stabilizim asocimit të Republikës së Shqipërisë,

Ky projektligj ka për qëllim të zhvillojë dhe mbështesë bashkëpunimin kulturor në mes vendeve të BE-së dhe Shqipërisë duke ofruar mundësi operatorëve kulturorë që të aplikojnë në këtë program për të përfituar mbështetje financiare dhe duke ndikuar në perspektivën e forcimit të dialogut ndërkulturor european dhe shkëmbimit të praktikave më të mira. Miratimi këtij akti është në përputhje me programin e qeverisë për forcimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve kulturore me vendet e tjera. Projektligji ka në fokus zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e kulturës, përhapjen e kulturës shqiptare dhe prezantimin e saj në vende të tjera dhe anasjelltas. Bashkëpunimi do të kontribuojë në mënyrë efektive për të nxitur mirëkuptimin e ndërsjellët midis popujve dhe dy vendeve.

Shqipëria ka marrë angazhim për të qenë pjesë këtij programi. Kjo marrëveshje është firmosur nga Ministrija e Kulturës me datën 7.12.2021 dhe është miratuar nga qeveria në datën 9 shkurt të këtij viti. Çfarë përfaqëson ky program? Ky program është programi kryesor i Komisionit European, i cili mbështet sektorët e kulturës dhe audiovizual. Programi u miratua fillimisht nga PE-ja në vitin 2013 dhe ishte një program 7-vjeçar. I pari ka filluar në vitin 2014 dhe është ratifikuar nga KE-ja deri në vitin 2020. Në vitin 2020 programi u rinovua për 7 vjet të tjerë, pra 2021-2027. Parimet kryesore janë të ruajë, të zhvillojë dhe promovojë diversitetin, trashëgiminë kulturore dhe gjuhësore europiane.

Mimi Kodheli - Ndjesë që ju ndërpres!

Ju lutem, ne e kemi relacionin përpara, prandaj ju na thoni dy fjalë shumë shkurt.

Entela Çipa – Programi në total ka një buxhet prej 2,4 miliardë euro, krahasuar me 1,4 miliardë që ishte programi 7-vjeçar i vitit 2014-2020. Nga ky program parashikohet të mbështeten rreth 250 mijë artistë me profesione të ndryshme kulturore, audiovizuale, organizata publike dhe private që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Shqipëri dhe në të gjithë BE-në. Sa i takon

anës financiare të vendit tonë paguhet vetëm një biletë hyrjeje, një kontribut prej 120 mijë eurosh, i cili kthehet në formën e një granti nga BE-ja. Kemi pjesëmarrjen nga përqindjet të çdo viti dhe nga kjo Shqipëria ka përfituar rreth 1,8 milionë euro dhe më shumë. Është një nga vendet që ka përfituar më tepër, pra OJF-të shqiptare që kanë përfituar nga aplikimet që kanë bërë nga ky program, ndërsa Shqipëria nga pjesa e kontributit paguan kosto stafi, qira, zyra, materiale konsumi, materiale promocionale dhe të tjera. Fushat kryesore janë kultura media dhe një fushë e shtrirë ndërsektoriale.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Kolegu Ajazi.

Besion Ajazi – Faleminderit!

Personalisht më vjen shumë mirë që relatoj një projektligj, për të cilin e kam marrë në avancë dakordësinë apo konsensusin e kolegëve të opozitës, kështu unë do ta kem më të thjeshtë ta relatoj atë.

Komisioni ynë si komision për dhënie mendimi ka për qëllim të shikojë përputhshmërinë e këtij projektligji me Kushtetutën, ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare. Ashtu siç u tha, Këshilli i Ministrave ka propozuar këtë projektligj bazuar në nenet 78, 83 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës. Gjithashtu, është bazuar edhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016 për marrëveshjet ndërkombëtare dhe është në përputhje me ligjin 9590 të vitit 2006 për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asocimit. Unë shkurtimisht do të citoja nga i gjithë ky relacion i gjatë një togfjalësh që mua më bëri përshtypje dhe që mendova ta nënvizoj “Europa Krijuese”. Ky program pra mbështet rreth 250 mijë artistë profesionistë kulturorë dhe audiovizivë, si edhe organizata publike dhe private që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e artit skenik, arteve të bukura, botimit, filmit, televizionit, muzikës, arteve ndërdisiplinore, trashëgimisë dhe industrisë së video-lojërave. Pra, aderimi në këtë marrëveshje është jo vetëm kusht për të përthithur këto fonde që BE-ja i vë në dispozicion të të gjitha vendeve aderuese në këtë marrëveshje, por është edhe një nxitje e të gjithë krijuesve shqiptarë pse jo edhe e të rinjve shqiptarë për të marrë pjesë sa më shumë në projekte në këtë marrëveshje dhe të përthithim sa më shumë fonde.

Faleminderit!

Ftoj kolegët ta miratojnë atë.

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Gjatë kohës që ju po relatoni unë po diskutoja me kolegun Klosi dhe mendoj se do të ishte në nderin tonë që kjo mbështetje t'i jepej sidomos artistëve të rinj, madje një artis të tillë zoti Klosi e ka në shtëpinë e tij.

Unë dua ta komplimentoj ministren për firmosjen e kësaj marrëveshjeje. Unë kam dy pyetje, pastaj ia jap fjalën zotit Kollçaku.

Pra, ne paguajmë një *fee* prej 120 mijë eurosh dhe kemi një përfitim prej 1 milionë euro?

Anila Muka - Po. Në këtë program çdo vit, deri në vitin 2027, Shqipëria duhet të paguajë 120 mijë euro dhe rreth 80% e kësaj kthehet në formë granti për Ministrinë e Kulturës. Kjo do të thotë se ne duhet të ngremë mekanizmin e *deskut* që ka një menaxher, një koordinator, i cili i organizon të gjitha sesionet e informimit që i vijnë në ndihmë të gjithë operatorëve ekonomikë që duan të aplikojnë në këtë program. Aktualisht ka disa thirrje për projekte gjatë vitit.

Mimi Kodheli – Kush e bën përzgjedhjen?

Anila Muka - Përzgjedhjen e bën Komisionit European. Por çfarë ndodh? Ne ofrojmë asistencën për operatorët. Duke parë qasjen të dobët të cilësisë së projekteve që propozohen sigurisht ne i asistojmë ata për të bërë projekte sa më të mira. Individët janë të përjashtuar, por ata mund t'i qasen OJF-ve me projektet e tyre.

Mimi Kodheli- Kjo nuk është e vlefshme në se ka një projekt që i tejkalon kufijtë e BE-së? Për shembull nëse ka vende si Turqia që duan të aplikojnë?

Anila Muka- Ne kemi vetëm një program të vendeve të BE-së. Sa i përket shteteve të tjera ka fonde të tjera që e japin këtë mundësi.

Mimi Kodheli – Zoti Kollçaku.

Bardhyl Kollçaku – Meqenëse në rrethe ka mungesë informacioni ose eksperience për aplikim, a ka menduar ministria si mund të ndihmojë grupet e të rinjve të valleve, të këngës, pra talentet e reja që të aplikojnë dhe të përfitojnë nga ky program?

Anila Muka - Faleminderit!

Duke qenë se programi është i ri, është menduar në ministri që mekanizmi i sesioneve të informimit të shtrihet në 12 qarqet e vendit.

Unë duke njohur edhe sektorin e shoqërisë civile, për shembull, Kuçova është shumë e mirë, ka organizata shumë të mira, kështu që do të ishte shumë me interes që të krijojmë

partneritete, sepse nuk mundet që një OJF, që vjen nga një rreth të fitojë një program. Bërja e rijetëzimit me operatorë të huaj do të ishte shumë e mirë edhe për ta për të rritur kapacitetet e tyre për të implementuar projekte, por edhe për të qenë fitues në këto projekte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sesionet kanë qenë shumë të mira. Kur flas për cilësinë e projekteve që ne adresojmë, unë mendoj se kjo është gjëja që ne duhet të ngremë në vëmendje të organizatave jofitimprurëse.

Nuk mundemi ne që të shkojmë vetëm në këto projekte. Duhet vetëm që të krijojmë *network*. Pra, nëpërmjet *network*-ut është rritur granti për vitin 2021-2027 me më shumë se 2,4 për shkak të Covid-it që në një farë mënyre pezulloi pjesën e aktiviteteve, por duhet të bëhemi më pragmatistë për të aplikuar me projekte me entitete të huaja. Në momentin që krijohet CV-ja personale, mund të aplikosh në projekte shumë të mira europiane. Marr shkas të flas edhe për projekte të tjera që do të vijnë nga IPA3, sepse bëhet luftë e madhe e vendeve për të fituar sa më shumë projekte. Shkrimi i projektit do asistencë teknike, nuk mundet një OJF- të aplikojë në fondet e BE-së thjesht se ka dëshirë. Nuk bëhet.

Mimi Kodheli– Kjo është e vjetër. Pa dyshim që kjo është e saktë. Ajo që besoj se pretendojnë kolegët këtu është që mbase duhet të ketë një vëmendje të shtuar dhe të mos jetë e gjitha e fokusuar në kryeqytet ose qytete e mëdha, për të kuptuar që informacioni ka shkuar në periferi dhe politikën e juaja të asistojnë më shumë periferinë.

Zoti Çollaku.

Kreshnik Çollaku – Projektit nuk ke se çfarë t'i kundërshtosh në parim, por unë i bashkohem shqetësimit të zotit Kollçaku, pavarësisht se e bëri në një trajtim lokal. Unë do ta trajtoja shqetësim pak më të gjerë. Ne e dimë në praktikë që historia e projekteve të tilla vendase ose ndërkombëtare e OJF-të që futen ose përfitojnë nga këto lloj projektësh, në të kundërtën e asaj që deklarohet në parim, kemi histori gjatë 30 vjetëve të politikave përzgjedhëse dhe përfituese të OJF-ve. Nuk dua të paragjykoj askënd, por çështja është se do t'i ndihmonte një zgjerim lokal i informacionit, i cili do të ndihmonte në rrëzimin e këtij paragjykimi. Unë e kuptoj se është një paragjykim kjo që po them tani, por, kur të vini vitin tjetër për të marrë po të njëjtin aprovim, duke qenë se ne votojmë për tarifën për buxhetin e shtetit, do të ishte e mirë të kishim relacionet përkatëse se cilat OJF kanë fituar, që ne të bëjmë një analizë, sepse ndodh që një OJF të marrë 5 projekte dhe 50 të tjera nuk kanë aksesin as të informacionit apo nuk arrijnë dot t'i përfitojnë.

E kuptoj që mund të jetë paragjykim sot, por ne duhet të krijojmë mekanizmin dhe ne duhet të jemi të vëmendshëm për të pasur një shpërndarje të drejtë dhe të vëmendshme për të krijuar kushte në pjesëmarrjen sa më të gjerë të OJF-ve që fitojnë këto projekte, sepse eksperiencat nuk janë të lavdishme kur bëhet fjalë për përfshirje, ata ngushtohen në dy-tri grupe që pastaj janë përfituese. Kështu që duhet vënë një lloj standardizimi.

Mimi Kodheli- Faleminderit, për vëzhgesën dhe shqetësimin, e vlerësoj.

Kalojmë në votim.

Kush është dakord? Kundër? Abstenime?

Më duhet të shënoj që ka dakordësuar edhe zoti Alizoti, edhe zoti Dule, edhe zoti Shehu, për projektligjin.

Neni 1 Kush është dakord? Kundër? Abstenime. Jemi të gjitha dakord.

Miratohet.

Neni 2 Kush është dakord? Kundër? Abstenime. Jemi të gjitha dakord.

Miratohet.

Kush është dakord për marrëveshjen në tërësi? Kundër? Abstenime. Jemi të gjitha dakord.

Miratohet.

Faleminderit!

Mbledhjen e komisionit e deklaroj të mbyllur.

Ruaj të drejtën për të kërkuar prezencën tuaj ditën e hënë, ora do t'ju njoftohet për të diskutuar për rezolutën.

MBYLLET MBLEDHJA